

Kadi i kërkuar nga vendi ynë për terrorizëm ka fituar procesin e tij civil ndaj familjeve të viktimave të 11 shtatorit

Kullat binjake, sheiku fiton gjyqin

Kadi akuzohej se kishte lidhje me ngjarjen e ndodhur në vitin 2001. Kadi tha se terrorizmi duhej luftuar

Sheiku, Yassin Kadi, i njohur në Shqipëri si pronar i dy Kullave Binjake, që ndodhen në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" dhe i akuzuar nga drejtësia shqiptare se ka shfrytëzuar sipërmarrjen e tij për të ndihmuar më shumë parash Al Kaedën, ka fituar gjyqin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për çështjen e 11 shtatorit. Sheiku Kadi, ka aritur të pezullojë çështjen civile të ngritur nga familjet e viktimave të 11 shtatorit. Gjyqtari George Daniels dha vendimin më 13 shtator në gjykatën e Nju Jorkut. Kadi është mes disa të akuzuarve: njerëz të kompanive dhe qeverive të botës myslimane, që janë cilësuar si të lidhur me Al Kaedën, prandaj në mënyrë direkte apo indirekte, ata kanë qenë përgjegjës për ngjarjen e 11 shtatorit. Çështjes i është referuar zakonisht pretendimit prej 3 bilion dollarësh të familjarëve, duke iu bazuar shumë përmbledhëse që pala paditëse kërkon për dëmin. Gjithësesi gjykata e ka pezulluar çështjen se pretendimet e ngritura ishin të pamjaftueshme. "Unë jam një njeri i pafajshëm. Gjithmonë më janë dhënë mundësi të ndershme nga shteti dhe në këtë rast unë kam pasur mundësinë të vërtetoj që këto akuzat janë të pavërteta", tha Kadi në proces. "Në biznesin tim individual, ose në aktivitetet që lidheshin me bamirësinë, kurë nuk kam mbështetur apo kam pasur ndërmend të mbështesja Osama Bin Laden ose Al Kaedën. Unë dhe të tjerë njerëz në pozicionin si unë, jemi viktimë të një "Guantanamoje" financiare që nuk duket sikur nuk do të përfundojë. Unë i dënoj pa hezitim, veprimet e Al Kaedës, po kështu edhe ato të 11 shtatorit 2001 dhe ndaj të njëjtën bindje me popullin amerikan dhe atë saudit, që terrorizmi i përfaqësuar nga Al Kaeda duhet luftuar. Gjithësesi beteja kundër terrorizmit nuk ka për t'u futur kurrë, nëse të drejtat bazike njerëzore injorohen, nëse njerëzve iu mohohet e drejta për të demonstruar pafajësinë e tyre dhe nëse shënjestrohen njerëz të pafajshëm si unë", tha Kadi. Mbrojtja e suksesshme e Kadisë në këtë çështje u krye



Yassin Kadi

nga David Geneson dhe Guy Martin, Cameron Doley dhe Maitre Saad Djebbar. Paditësit kanë argumentuar se Kadi është cilësuar nga Shtetet e Bashkuara, si një terrorist botëror bazuar në mbështetjen e tij ndaj Al Kaedës. Pala paditëse ka argumentuar më tej se Kadi kryesonte një shoqatë bamirëse saudite, "Muwafaq". Një bazë e Al Kaedës që transferonte miliona dollarë në llogari të organizatave terroriste. Kadi hapi një degë të kësaj shoqate në Delaware, në Amerikë, në vitin 1992 që operoi deri në vitin 1997, si shoqatë bamirëse. Gjatë kësaj kohe Kadi pretendohet se ka shpenzuar 15-20 milion dollarë nga paratë e tij në veprimet ditore për Muwafaq. Po kështu, Kadi

pretendohet të ketë dhënë donacione në organizata të dyshimta bamirëse në SHBA, si dhe ka transferuar para në individë në SHBA, të cilët transferonin mbrapsht shumë të tëra në mbështetje të terrorizmit vendas. Paditësit kanë thënë se kompanitë që kontrolloheshin nga Kadi, kanë shërbyer si mjete, përmes të cilave ai ka investuar miliona dollarë në kompani në SHBA. Ai është gjithashtu drejtor i kompanisë Global Dimond Resources, me bazë në Nevada. Ndërkohë që sipas paditësve, shumë prej kompanive që Kadi ka pasur të bëjë kanë lidhje me terrorizmin. Mësohet se Kadi ka qenë i përfshirë në investimet e Reale State, në Masaçusete dhe Pensilvani.

R. Çaushaj

Pesë muajt e fundit, banda kishte vjedhur 6 dyqane

Krimet e Rënda, dënuan me 4 vjet administratorin



Nga gjyqi i Hamzeh Abu Rayyan

Gjykata e Krimeve të Rënda dënoi në 22 dhjetor të vitit 2009 me 4 vjet burgim administratorin e Yassin Kadisë, për veprën penale të "shfrytëzimit të fondëve dhe pasurive të tjera që financojnë terrorizmin". Nga hetimet e kryera nga Prokuroria e Krimeve të Rënda Hamzeh Abu Rayyan, u akuzua se i ka shkakuar shtetit një dëm prej 80 mijë euro. Ai ushtronte detyrën e tij si administrator i shoqërisë "Llohall", sh.p.k. me pronar Yassin Al Kadi, i cili ndodhej që nga 17 shtatori 2001 në listën OKB-së, si i dyshuar për fi-

nancimin e terrorizmit. Kjo shoqëri, nën administrimin e Abu Rajanit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit, vazhonte prej kohësh të ushtronte aktivitetin e biznesit nëpërmjet dhënies me qira të pasurive të paluajtshme. Nga hetimi gjyqësor është provuar se vetëm në Tiranë, shoqëria "Llohall" sh.p.k. ka 19 objekte të dhëna me qira, dhe pagesat për këto aktivitete ishin kryer me para në dorë, duke mos kaluar nëpërmjet sistemit bankar. Vendimi për Abu Rayyan u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

Po verifikohet gjendja mendore e 32-vjeçarit Ilir Memo

Kërcënonte me gjobëvënie farmacistin, lirohet nga gjykata

KËRCËNIMET

Nga hetimet e kryera nga Prokuroria e Krimeve të Rënda i pandehuri ka përdorur disa karta telefonike për të dërguar mesazhet e tij, në mënyrë të tillë që të mos diktohej prej të dëmtuarit. Prokurorisë i është dashur disa kohë për të zbardhur identitetin e tij.

penale të "Shtyrëzimit për dhënie pasurie". I ndaluar akuzohet se në datën 28 gusht 2010, me anë të një letrë kërcënuese i ka kërkuar në formë gjobe pronarit të një farmacie në kryeqytet, shumë e parave prej 10 mijë euro. Pas dërgimit të

disa mesazheve, autori i ka kërkuar të dëmtuarit që të kryente hapjen e një numri llogarie bankare në një nga bankat në kryeqytet, për të aplikuar për kartë-viza dhe më pas të dërgonte po me mesazh PIN-in e kartës, me synim për vetësimin e

shumës së parave nëpërmjet rrjetit të ATM-ve. Pas hetimeve të kryera në ngarkim të tij, ka rezultuar se ky shtetas ka dërguar mbi 40 mesazhe telefonike kërcënuese nga numra të ndryshëm celulari dhe për shkak të vështirësisë së identifikimit të përdoruesve të numrave, ka vështirësuar më tej identifikimin e tij. I ndaluar u lokalizua nga policia në sheshin "Nënë Tereza" në Tiranë, gjatë momenteve kur ai ishte duke shkuar drejt Rrugës së Elbasanit.

TIRANË. Kërcënonte farmacistin duke i kërkuar në formë gjobe shumë e 10 mijë eurove, Gjykata e Krimeve të Rënda e lë në "arrest shtëpie". Ilir Memo, 32 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, nuk ka dhënë pretendime përpara gjykatës. Prokuroria ka kërkuar ndaj gjyqtarit të gatshëm masën e sigurisë "arrest shtëpie", për të parë nëse i akuzuari ka probleme mendore, ose jo, apo është përdorues droge. Memo u arrestua dy ditë më parë në sajë të operacionit të koduar "Mesazhi". Ndaj tij Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë ka regjistruar procedimin penal Nr. 81 të vitit 2010, duke e akuzuar për veprën



Foto ilustruese